UDHËZIM
Nr. 7, datë 15.7.2026

PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE, KRITEREVE, PROCEDURAVE DHE MËNYRAVE PËR DHËNIEN E MIRATIMIT, PËR EKSPOZIMIN E PASURIVE KULTURORE, MASAVE TË NEVOJSHME PËR RUAJTJEN DHE GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË TYRE, SI DHE PROCEDURAVE, MËNYRAVE DHE KUSHTEVE TË LËSHIMIT TË DEKLARATËS SË MARRJES PËRSIPËR TË RREZIKUT

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 99, pikave 3 dhe 5, të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

1. Ky udhëzim përcakton:

a) kushtet, kriteret, procedurat dhe mënyrat për dhënien e miratimit për huapërdorjen e pasurive kulturore të luajtshme për shfaqje në ekspozita, panaire dhe ngjarje kulturore;

b) masat e nevojshme për ruajtjen, mbrojtjen dhe garantimin e integritetit të pasurive kulturore gjatë transportit, ekspozimit dhe kthimit të tyre;

c) procedurat, mënyrat dhe kushtet për lëshimin e deklaratës së marrjes përsipër të rrezikut, sipas nenit 99, pika 5, të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", të ndryshuar.

Neni 2
Fusha e zbatimit

Ky udhëzim zbatohet për pasuritë kulturore të luajtshme, të përcaktuara në nenin 99, pika 2, të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", të ndryshuar, të cilat jepen në huapërdorim për qëllime shfaqjeje në ekspozita, panaire ose ngjarje kulturore, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 3
Përkufizime

Për qëllimet e këtij udhëzimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "Huapërdorues" është personi fizik ose juridik, publik ose privat, që merr në përdorim të përkohshëm një pasuri kulturore për qëllime shfaqjeje në ekspozita, panaire ose ngjarje kulturore;

b) "Integritet" është ruajtja e karakteristikave materiale, historike dhe estetike që përbëjnë vlerën e tij kulturore;

c) "Institucion administrues" është institucioni publik ose privat që administron pasurinë kulturore objekt huapërdorimi;

d) "Raport i gjendjes" është dokumenti teknik që pasqyron gjendjen fizike dhe konservuese të pasurisë kulturore përpara dorëzimit dhe pas kthimit të saj;

e) “Projekt ekspozimi” është dokumentacioni teknik dhe kuratorial që përshkruan konceptin, qëllimin, organizimin, kushtet e ekspozimit dhe masat e sigurisë për pasurinë kulturore;

f) “Deklaratë e marrjes përsipër të rrezikut” është deklarata e lëshuar nga institucioni shtetëror organizator i ekspozitës, panairit ose ngjarjes kulturore, me të cilën merret përsipër përgjegjësia për dëmtimin, humbjen, vjedhjen ose cenimin e integritetit të pasurisë kulturore, në përputhje me nenin 99, pika 5, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar.

KREU II
KUSHTET, KRITERET DHE PROCEDURA PËR DHËNIEN E MIRATIMIT

Neni 4
Autoriteti kompetent

Leja për huapërdorjen e pasurive kulturore për shfaqje në ekspozita, panaire dhe ngjarje kulturore jepet me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, pas shqyrtimit të kërkesës dhe verifikimit të përmbushjes së kushteve, kritereve dhe kërkesave të përcaktuara në këtë udhëzim.

Neni 5
Kriteret e vlerësimit

Kërkesa për dhënien e lejes vlerësohet, në bazë të:

a) rëndësisë kulturore, historike, artistike, shkencore ose dokumentare të pasurisë kulturore;

b) gjendjes së konservimit dhe ndjeshmërisë së saj ndaj faktorëve të jashtëm;

c) nivelit të rrezikut që lidhet me transportin, paketimin, vendosjen në ekspozim, ekspozimin, heqjen nga ekspozimi dhe kthimin e pasurisë kulturore;

ç) ndikimit të mundshëm mbi integritetin të pasurisë kulturore;

d) përputhshmërisë së projektit të ekspozimit me vlerat dhe karakteristikat e pasurisë kulturore;

dh) kohëzgjatjes së ekspozimit;

e) kapacitetit teknik dhe organizativ të huapërdoruesit;

ë) përmbushjes së standardeve të ruajtjes dhe sigurisë.

Neni 6
Kushtet për dhënien e lejes

Ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore jep leje për huapërdorje vetëm kur provohet, se:

a) ambientet e ekspozimit sigurojnë kushte të përshtatshme ruajtjeje dhe monitorimi të pasurisë kulturore, përfshirë kushtet mikroklimatike, si: temperatura, lagështia relative dhe ndriçimi, në përputhje me natyrën dhe gjendjen e konservimit të pasurisë kulturore;

b) janë garantuar kushtet e sigurisë fizike të ambienteve ku do të ekspozohet pasuria kulturore;

c) ekzistojnë masa mbrojtëse kundër zjarrit, përmbytjeve dhe rreziqeve të tjera që mund të cenojnë integritetin e pasurisë kulturore;

ç) janë parashikuar masa të përshtatshme për transportin, paketimin, vendosjen në ekspozim, ekspozimin dhe heqjen nga ekspozimi të pasurisë kulturore;

d) është siguruar garancia e lëshuar nga një bankë e nivelit të dytë, sipas nenit 99, pika 4, të ligjit nr. 27/2018 ose deklarata e marrjes përsipër të rrezikut sipas nenit 99, pika 5, të këtij ligji.

Neni 7
Rastet e refuzimit të lejes

Ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore refuzon dhënien e lejes, kur:

a) pasuria kulturore ndodhet në gjendje të tillë konservimi që transporti ose ekspozimi mund të cenojë integritetin e saj, ose, për shkak të karakteristikave të saj materiale, mund të dëmtohet lehtësisht nga transporti, ekspozimi ose nga ndryshimet e kushteve ambientale;

b) pasuria kulturore përbën pjesë të fondit thelbësor të një seksioni të rëndësishëm dhe organik të një muzeu, pinakoteke, galerie, arkivi ose biblioteke, apo të një koleksioni artistik ose bibliografik, dhe largimi i saj cenon integritetin, funksionin publik ose karakterin përfaqësues të fondit përkatës;

c) nuk plotësohen kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë udhëzim;

ç) dokumentacioni i paraqitur rezulton i pasaktë ose i pavërtetë.

KREU III
PROCEDURA E PARAQITJES DHE E SHQYRTIMIT TË KËRKESËS

Neni 8
Paraqitja e kërkesës

1. Subjekti i interesuar paraqet kërkesë për dhënien e lejes për huapërdorjen e pasurive kulturore për shfaqje në ekspozita, panaire ose ngjarje kulturore, jo më vonë se 45 (dyzet e pesë) ditë përpara datës së planifikuar të fillimit të veprimtarisë.

2. Kërkesa paraqitet nëpërmjet sistemit elektronik "*e-Albania*" dhe përmban:

a) të dhënat identifikuese të kërkuesit, si emër/emërtim tregtar, NUIS, adresa/selia;

b) lista e pasurive kulturore, për të cilat paraqitet kërkesa;

c) projektin e ekspozimit, ku përcaktohen qëllimi, vendi, kohëzgjatja dhe koncepti kuratorial;

ç) dokumentimin fotografik të secilës pasuri kulturore;

d) planin teknik të ekspozimit, që përfshin masat e ruajtjes, sigurisë dhe kushtet e ekspozimit;

dh) dokumentacionin që provon vlerën financiare të pasurisë kulturore, të lëshuar nga institucioni administrues ose nga ekspertë të kualifikuar sipas legjislacionit në fuqi, për qëllime të përllogaritjes së vlerës së sigurimit ose të garancisë bankare;

e) projektkontratën ose projektmarrëveshjen ndërmjet kërkuesit dhe palës pritëse, që provon angazhimin e palëve për të shfaqur pasurinë kulturore në ekspozitën, panairin ose ngjarjen kulturore përkatëse;

ë) dokument që vërteton garancinë e lëshuar nga një bankë e nivelit të dytë, në masën 1% të vlerës së deklaruar ose kërkesën për miratimin e zëvendësimit të garancisë me deklaratën e marrjes përsipër të rrezikut, sipas kreut V të këtij udhëzimi.

3. Në rastet kur subjekti i interesuar nuk është institucioni administrues i pasurisë kulturore objekt i kërkesës, struktura përgjegjëse e ministrisë kërkon nga institucioni administrues i pasurisë kulturore dokumentacionin teknik dhe mendimin për huapërdorjen, duke përfshirë raportin e gjendjes së konservimit, dokumentacionin fotografik, si dhe vlerësimin mbi përshtatshmërinë e zhvendosjes, transportit dhe ekspozimit të pasurisë kulturore.

4. Institucioni administrues paraqet dokumentacionin dhe mendimin sipas pikës 3 të këtij neni, brenda 3 (tre) ditëve pune nga marrja e njoftimit, duke mbajtur përgjegjësi për saktësinë dhe plotësinë e të dhënave teknike të paraqitura.

Neni 9
Shqyrtimi i kërkesës

1. Struktura përgjegjëse e ministrisë verifikon dokumentacionin e paraqitur nga kërkuesi.

2. Në rast se dokumentacioni është i paplotë, kërkuesi njoftohet për plotësimin e mangësive brenda një afati prej 5 (pesë) ditësh nga data e njoftimit.

3. Për vlerësimin e kërkesës, ministria kërkon mendim teknik nga institucioni përgjegjës, sipas tipologjisë së pasurisë kulturore, lidhur me gjendjen e konservimit të pasurisë kulturore dhe masat e nevojshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e saj.

4. Për verifikimin e statusit të pasurisë kulturore dhe të të dhënave të regjistrimit, kërkohet konfirmim nga Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore.

5. Kur pasuria kulturore administrohet nga muze, galeri arti, bibliotekë, arkiv ose institucion tjetër administrues, ministria merr mendimin e institucionit administrues, lidhur me gjendjen e konservimit të pasurisë kulturore, përshtatshmërinë e zhvendosjes, transportit dhe ekspozimit të saj, si dhe masat e nevojshme për ruajtjen dhe garantimin e integritetit fizik, material dhe estetik të saj gjatë të gjithë procesit, nga marrja në dorëzim, paketimi, zhvendosja, transporti, ekspozimi dhe kthimi pranë institucionit administrues.

6. Kërkesa shqyrtohet brenda 20 (njëzet) ditëve pune nga data e paraqitjes së dokumentacionit të plotë.

7. Vendimi për miratimin ose refuzimin e lejes jepet i arsyetuar dhe i njoftohet subjektit kërkues.

8. Leja mund të shoqërohet me kushte, kufizime ose masa të posaçme për garantimin e ruajtjes dhe integritetit të pasurisë kulturore.

Neni 10
Vlefshmëria e lejes

1. Leja hyn në fuqi në datën e njoftimit të subjektit kërkues, përveç rasteve kur në urdhrin e ministrit përcaktohet ndryshe.

2. Leja është e vlefshme vetëm për pasurinë kulturore, veprimtarinë, vendin dhe afatin e përcaktuar në të.

3. Subjekti i pajisur me leje është i detyruar të zbatojë kushtet, kufizimet dhe masat e përcaktuara në urdhrin përkatës dhe në këtë udhëzim.

4. Çdo ndryshim i elementeve mbi bazën e të cilëve është dhënë leja kërkon miratim paraprak nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

5. Mosrespektimi i kushteve të lejes përbën shkak për shfuqizimin e saj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KREU IV
MASAT PËR RUAJTJEN DHE GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PASURIVE KULTURORE

Neni 11
Masat për ruajtjen e pasurisë kulturore

1. Huapërdoruesi merr të gjitha masat e nevojshme për ruajtjen dhe garantimin e integritetit të pasurisë kulturore gjatë transportit, ekspozimit dhe kthimit të saj.

2. Huapërdoruesi ka detyrimin për të garantuar që ambientet e ekspozimit kanë kushte të përshtatshme ruajtjeje dhe monitorimi të pasurisë kulturore, përfshirë kushtet mikroklimatike, si: temperatura, lagështia relative dhe ndriçimi, në përputhje me natyrën dhe gjendjen e konservimit të pasurisë kulturore.

3. Kushtet mikroklimatike monitorohen dhe dokumentohen gjatë të gjithë periudhës së ekspozimit dhe të dhënat përkatëse vihen në dispozicion të ministrisë ose institucioneve të specializuara të trashëgimisë kulturore, me kërkesën e tyre.

4. Materialet dhe pajisjet që përdoren për ekspozimin e pasurisë kulturore duhet të jenë të përshtatshme për ruajtjen e saj dhe të mos cenojnë integritetin fizik ose material të pasurisë kulturore.

Neni 12
Masat e sigurisë

1. Ambientet ku ekspozohet pasuria kulturore pajisen me sisteme sigurie dhe mbrojtjeje të përshtatshme për natyrën dhe vlerën e pasurisë kulturore që ekspozohet.

2. Ambientet e ekspozimit duhet të jenë të pajisura me sisteme mbrojtjeje kundër zjarrit, sisteme alarmi dhe sisteme monitorimi.

3. Kur natyra, vlera ose gjendja e konservimit të pasurisë kulturore e kërkon, ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore mund të vendosë masa shtesë sigurie.

4. Para marrjes në dorëzim të pasurisë kulturore, huapërdoruesi paraqet planin e masave për menaxhimin e rrezikut dhe të situatave emergjente, i cili përfshin procedurat e ndërhyrjes në rast zjarri, përmbytjeje ose rreziqesh të tjera që mund të cenojnë integritetin e pasurisë kulturore.

Neni 13
Transporti dhe trajtimi i pasurisë kulturore

1. Transporti, paketimi, vendosja në ekspozim, ekspozimi dhe heqja nga ekspozimi i pasurisë kulturore kryhen në mënyrë të tillë që të mos cenojnë integritetin e pasurisë kulturore.

2. Pasuria kulturore transportohet në përputhje me kërkesat që rrjedhin nga natyra, përmasat, materiali dhe gjendja e konservimit të saj.

3. Gjatë transportit dhe trajtimit të pasurisë kulturore merren masat e nevojshme për mbrojtjen e tyre nga dëmtimi, humbja, vjedhja ose çdo rrezik tjetër që mund të cenojë integritetin e tyre.

4. Huapërdoruesi siguron mbulimin me sigurim të pasurive kulturore objekt huapërdorimi gjatë të gjithë periudhës së huapërdorimit, nga momenti i marrjes në dorëzim deri në kthimin e tyre pranë institucionit administrues, përfshirë paketimin, transportin, qëndrimin në ambientet pritëse dhe ekspozimin, në përputhje me vlerën e deklaruar të tyre.

Neni 14
Monitorimi i gjendjes së pasurisë kulturore

1. Për çdo pasuri kulturore që është objekt huapërdorimi hartohet raporti i gjendjes përpara dorëzimit dhe pas kthimit të saj, nga institucioni përkatës administrues.

2. Dorëzimi, marrja në dorëzim dhe kthimi i pasurisë kulturore dokumentohen me procesverbal dhe pasqyrohen në raportin përfundimtar.

3. Çdo dorëzim, marrje në dorëzim ose zhvendosje e pasurisë kulturore jashtë institucionit administrues dokumentohet me procesverbal dhe raport gjendjeje. Kur kërkohet nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore ose nga institucioni administrues, këto veprime kryhen në prani të përfaqësuesve të institucionit administrues, Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore ose institucioneve të tjera të specializuara të trashëgimisë kulturore.

4. Kur pasuria kulturore transportohet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, dorëzimi dhe marrja në dorëzim pranë institucionit pritës dokumentohen sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshjen e huapërdorimit dhe raportet përkatëse të gjendjes.

5. Gjatë periudhës së huapërdorimit ndalohet kryerja e ndërhyrjeve konservuese, restauruese ose e çdo ndërhyrjeje tjetër që mund të ndikojë në integritetin e pasurisë kulturore, pa miratimin paraprak me shkrim të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe të institucionit administrues.

Neni 15
Detyrimi për njoftim

1. Çdo dëmtim, humbje, vjedhje ose rrethanë tjetër që mund të cenojë integritetin e pasurisë kulturore i njoftohet menjëherë ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe institucionit administrues.

2. Njoftimi sipas pikës 1 të këtij neni bëhet jo më vonë se 2 (dy) orë nga momenti i konstatimit të ngjarjes.

Neni 16
Përgjegjësia e huapërdoruesit

1. Huapërdoruesi është përgjegjës për ruajtjen, sigurimin dhe garantimin e integritetit të pasurisë kulturore nga momenti i marrjes në dorëzim deri në kthimin e saj pranë institucionit administrues.

2. Në rast dëmtimi, humbjeje, vjedhjeje ose cenimi tjetër të integritetit të pasurisë kulturore, përgjegjësia dhe pasojat financiare përcaktohen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe dokumentacionin teknik përkatës.

KREU V
PROCEDURAT, MËNYRAT DHE KUSHTET PËR LËSHIMIN E DEKLARATËS SË MARRJES PËRSIPËR TË RREZIKUT

Neni 17
Fusha e zbatimit

1. Deklarata e marrjes përsipër të rrezikut lëshohet për ekspozitat, panairet ose ngjarjet kulturore që zhvillohen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe promovohen nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore ose organizohen me pjesëmarrjen e institucioneve shtetërore, në përputhje me nenin 99, pika 5, të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", të ndryshuar.

2. Deklarata e marrjes përsipër të rrezikut zëvendëson garancinë e lëshuar nga një bankë e nivelit të dytë, të parashikuar në nenin 99, pika 4, të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", të ndryshuar.

Neni 18
Paraqitja e kërkesës për zëvendësim

1. Institucioni shtetëror organizator që kërkon zëvendësimin e garancisë bankare me deklaratën e marrjes përsipër të rrezikut e paraqet këtë kërkesë njëkohësisht me kërkesën për dhënien e miratimit për huapërdorimin e pasurive kulturore, sipas nenit 8 të këtij udhëzimi.

2. Kërkesa për zëvendësimin e garancisë bankare përfshihet në dokumentacionin fillestar të paraqitur nëpërmjet sistemit elektronik "*e-Albania*" dhe nuk mund të paraqitet pas dorëzimit të kërkesës për miratim.

3. Në kërkesë identifikohen pasuritë kulturore, për të cilat kërkohet zëvendësimi i garancisë bankare, si dhe institucioni shtetëror që merr përsipër rrezikun.

Neni 19
Kushtet për miratimin e kërkesës

1. Ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore miraton zëvendësimin e garancisë bankare me deklaratën e marrjes përsipër të rrezikut kur plotësohen njëkohësisht këto kushte:

a) veprimtaria zhvillohet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;

b) veprimtaria promovohet nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore ose organizohet me pjesëmarrjen e institucioneve shtetërore;

c) institucioni shtetëror organizator disponon kapacitetet administrative, teknike dhe financiare të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga marrja përsipër e rrezikut;

ç) institucioni shtetëror organizator disponon plan të dokumentuar për menaxhimin e rrezikut dhe situatave emergjente që mund të cenojnë integritetin e pasurive kulturore objekt huapërdorimi.

2. Për qëllim të zbatimit të shkronjës "c", të pikës 1, të këtij neni, kapacitetet administrative, teknike dhe financiare të institucionit shtetëror organizator vlerësohen mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur prej tij, përfshirë aktet e organizimit institucional, planin e menaxhimit të rrezikut, masat e sigurisë, dokumentacionin buxhetor dhe çdo dokument tjetër të nevojshëm që provon aftësinë për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga deklarata e marrjes përsipër të rrezikut.

Neni 20

Shqyrtimi i kërkesës dhe lëshimi i deklaratës

1. Kërkesa për zëvendësimin e garancisë bankare shqyrtohet njëkohësisht me kërkesën për miratimin e huapërdorimit të pasurisë kulturore, sipas procedurës dhe afateve të përcaktuara në kreun III të këtij udhëzimi.

2. Struktura përgjegjëse e ministrisë verifikon dokumentacionin e paraqitur dhe përmbushjen e kushteve të përcaktuara në nenin 19 të këtij udhëzimi.

3. Kur dokumentacioni është i paplotë ose kërkon sqarime të mëtejshme, institucioni kërkues njoftohet elektronikisht, nëpërmjet sistemit "*e-Albania*", për plotësimin e mangësive brenda afatit të përcaktuar në nenin 9 të këtij udhëzimi.

4. Vendimi për pranimin ose refuzimin e kërkesës për zëvendësimin e garancisë bankare jepet në të njëjtin akt administrativ me vendimin për miratimin ose refuzimin e huapërdorimit të pasurisë kulturore.

5. Në rast miratimi, deklarata e depozituar nga institucioni shtetëror organizator, sipas nenit 18 të këtij udhëzimi, konsiderohet e pranuar dhe bëhet pjesë e dosjes.

6. Deklarata depozitohet nëpërmjet sistemit elektronik "*e-Albania*" dhe nënshkruhet nga titullari i institucionit shtetëror organizator ose nga personi i autorizuar prej tij.

7. Pas verifikimit të përputhshmërisë së deklaratës me kushtet e miratuara, struktura përgjegjëse e ministrisë e administron atë në dosjen e procedurës dhe njofton institucionin administrues të pasurisë kulturore.

8. Institucioni administrues nuk mund të dorëzojë pasurinë kulturore për huapërdorim përpara administrimit në dosje të deklaratës së marrjes përsipër të rrezikut ose të garancisë bankare, sipas rastit.

9. Në rast refuzimi të kërkesës për zëvendësimin e garancisë bankare me deklaratën e marrjes përsipër të rrezikut, kërkuesi njoftohet brenda 3(tre) ditëve pune nga data e njoftimit të vendimit për paraqitjen e garancisë së lëshuar nga një bankë e nivelit të dytë, sipas nenit 99, pika 4, të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", të ndryshuar.

10. Kërkuesi paraqet garancinë bankare jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë pune nga data e njoftimit.

11. Deri në paraqitjen e garancisë bankare, procedura për shqyrtimin e kërkesës për dhënien e lejes së huapërdorimit pezullohet.

12. Në rast se garancia bankare nuk paraqitet brenda afatit të përcaktuar në pikën 10 të këtij neni, kërkesa për dhënien e lejes së huapërdorimit refuzohet.

Neni 21

Përmbajtja e deklaratës

1. Deklarata e marrjes përsipër të rrezikut përmban të paktën:

a) emërtimin e institucionit shtetëror që merr përsipër rrezikun;

b) identifikimin e pasurive kulturore objekt të deklaratës;

c) vendin dhe kohëzgjatjen e ekspozitës, panairit ose ngjarjes kulturore;

ç) deklarimin e marrjes përsipër të përgjegjësisë për dëmtimin, humbjen, vjedhjen ose cenimin e integritetit të pasurive kulturore gjatë periudhës së huapërdorimit;

d) detyrimin për marrjen e masave të ruajtjes, sigurisë dhe monitorimit sipas këtij udhëzimi;

dh) datën e lëshimit dhe nënshkrimin e titullarit të institucionit shtetëror ose të personit të autorizuar prej tij;

e) vlerën e deklaruar të pasurisë kulturore objekt huapërdorimi;

ë) angazhimin e institucionit deklarues për përmbushjen e detyrimeve financiare që rrjedhin nga përgjegjësia e tij për dëmtimin, humbjen, vjedhjen ose cenimin tjetër të integritetit të pasurisë kulturore gjatë periudhës së huapërdorimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe vlerësimin teknik të dëmit.

Neni 22

Vlefshmëria e deklaratës

1. Deklarata e marrjes përsipër të rrezikut është e vlefshme vetëm për pasuritë kulturore, veprimtarinë, vendin dhe afatin e përcaktuar në të.

2. Vlefshmëria e deklaratës fillon në datën e marrjes në dorëzim të pasurisë kulturore dhe përfundon me kthimin e saj pranë institucionit administrues dhe nënshkrimin e dokumentacionit përkatës të dorëzimit, sipas pikës 2, të nenit 14 të këtij udhëzimi.

3. Çdo ndryshim i elementeve mbi bazën e të cilave është lëshuar deklarata kërkon miratim paraprak nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

4. Në rast të mosrespektimit të kushteve të përcaktuara në këtë udhëzim ose në vendimin e miratimit, ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore mund të shfuqizojë miratimin, sipas legjislacionit në fuqi. Në këtë rast deklarata e marrjes përsipër të rrezikut humbet vlefshmërinë.

KREU VI

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 23

Ngarkimi për zbatim

Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi strukturat përgjegjëse të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore dhe institucionet e tjera publike të përfshira sipas kompetencave të tyre.

Neni 24

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT

Blendi Gonxhja

SHTOJCA NR. 1

MODEL I DEKLARATËS SË MARRJES PËRSIPËR TË RREZIKUT

DEKLARATË E MARRJES PËRSIPËR TË RREZIKUT

Në mbështetje të nenit 99, pika 5, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar, si dhe të kreut V, të udhëzimit nr. ____, datë ___.____.2026, “Për përcaktimin e kushteve, kritereve, procedurave dhe mënyrave për dhënien e miratimit për ekspozimin e pasurive kulturore, masave të nevojshme për ruajtjen dhe garantimin e integritetit të tyre, si dhe procedurave, mënyrave dhe kushteve të lëshimit të deklaratës së marrjes përsipër të rrezikut”,

INSTITUCIONI SHTETËROR

Emërtimi: _____

NUIS-i: _____

Adresa: _____

Përfaqësuar nga: _____

Funksioni: _____

DEKLARON SE:

1. Merr përsipër rrezikun dhe përgjegjësinë për dëmtimin, humbjen, vjedhjen ose çdo cenim tjetër të integritetit të pasurive kulturore të identifikuara në këtë deklaratë, gjatë periudhës së huapërdorimit të tyre.

2. Pasuritë kulturore objekt i kësaj deklarate do të ekspozohen, në kuadër të:

Emërtimi i ekspozitës/panairit/ngjarjes kulturore:

_____

Vendi i zhvillimit:

_____

Periudha e zhvillimit: nga ___.___._____ deri më ___.___._____.

3. Pasuritë kulturore, objekt i kësaj deklarate, janë:

Nr.	Emërtimi i pasurisë kulturore	Numri i regjistrimit	Institucioni administrues	Vlera e deklaruar (lekë)
1				
2				
3				

Vlera totale e deklaruar e pasurive kulturore: _____ lekë.

4. Disponon kapacitetet administrative, teknike dhe financiare të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kjo deklaratë.

5. Angazhohet për përmbushjen e detyrimeve financiare që rrjedhin nga përgjegjësia e tij për dëmtimin, humbjen, vjedhjen ose cenimin tjetër të integritetit të pasurive kulturore, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe vlerësimin teknik përkatës.

6. Janë marrë dhe do të zbatohen gjatë të gjithë periudhës së huapërdorimit masat e nevojshme për:

a) ruajtjen e pasurive kulturore;

b) sigurinë fizike të ambienteve të ekspozimit;

c) monitorimin e kushteve mikroklimatike;

ç) menaxhimin e rrezikut dhe situatave emergjente;

d) transportin, paketimin, vendosjen në ekspozim, ekspozimin, heqjen nga ekspozimi të pasurive kulturore.

7. Çdo dëmtim, humbje, vjedhje ose ngjarje tjetër që mund të cenojë integritetin e pasurive kulturore do t’i njoftohet menjëherë ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe institucionit administrues, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

8. Kjo deklaratë lëshohet për qëllime të zëvendësimit të garancisë së lëshuar nga një bankë e nivelit të dytë, sipas nenit 99, pika 5, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar.

9. Kjo deklaratë është e vlefshme vetëm për pasuritë kulturore, veprimtarinë, vendin dhe afatin e përcaktuar në të, si dhe për periudhën nga marrja në dorëzim e pasurive kulturore deri në kthimin e tyre pranë institucionit administrues.

Deklaruesi
TITULLAR I INSTITUCIONIT SHTETËROR
(emër, mbiemër, funksion, nënshkrim, vula e institucionit, data)

Shënim. Kjo deklaratë depozitohet pranë ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, në kuadër të procedurës së miratimit të huapërdorimit të pasurive kulturore dhe bëhet pjesë e dosjes administrative përkatëse.